

Rritja e nivelit të trajnimit të nëpunësve civilë dhe bashkëpunimi ndërinstytucional ishin në fokus të takimit ndërmjet KMSHC-së dhe ASPA-s

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), në një takim me Drejtoreshën e Shkollës së Administratës Publike, znj. Emona Boçe, vlerësoi punën e ASPA-s, në drejtim të formimit profesional të nëpunësve civilë, si dhe diskutoi në lidhje me nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi mes të dy institucioneve.



Komisioneri solli në vëmendje rëndësinë e përfshirjes në kurikula edhe të problematikave që konstatohen gjatë procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil.

Në qendër të diskutimit ishte edhe trajnimi i vazhdueshëm për njësitë përgjegjëse të burimeve njerëzore, për të njohur më mirë institutet e ligjit “Për nëpunësin civil”.



Pas takimit, Komisioneri dhe Drejtori i ASPA-s, morën pjesë në ceremoninë e dorëzimit të certifikatave për pjesëmarrësit në trajnimin e zhvilluar, në ambjentet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.